LIGJ
Nr. 122/2021

PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR. 99/2021, "PËR RATIFIKIMIN E VENDIMIT TË KOMITETIT TË PËRBASHKËT EFTA–SHQIPËRI NR. 1, I VITIT 2021, MIRATUAR MË 24.6.2021, PËR NDRYSHIMIN E PROTOKOLLIT B TË MARRËVESHJES SË TREGTISË SË LIRË NDËRMJET SHTETEVE TË EFTA-s DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, LIDHUR ME PËRKUFIZIMIN E KONCEPTIT TË 'PRODUKTEVE ORIGJINUESE' DHE METODAT E BASHKËPUNIMIT ADMINISTRATIV, DHE NDRYSHIMIN E MARRËVESHJEVE PËR BUJQËSINË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KONFEDERATËS SË ZVICRËS, DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS SË ISLANDËS, SI PJESË PËRBËRËSE E SAJ"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 99/2021, "Për ratifikimin e vendimit të Komitetit të Përbashkët EFTA–Shqipëri nr. 1, i vitit 2021, miratuar më 24.6.2021, për ndryshimin e protokollit B të Marrëveshjes se Tregtisë së Lirë ndërmjet shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Shqipërisë, lidhur me përkufizimin e konceptit të 'produkteve origjinuese' dhe metodat e bashkëpunimit administrativ, dhe ndryshimin e marrëveshjeve për bujqësinë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës së Zvicrës, dhe Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Islandës, si pjesë përbërëse e saj", bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në titull dhe në nenin 1 të ligjit, pas fjalëve "Republikës së Islandës" shtohen fjalët "si dhe Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë,".

Neni 2

Bashkëlidhur ligjit shtohet si pjesë përbërëse e tij marrëveshja ndryshuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Norvegjisë, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 9.12.2021.

Shpallur me dekretin nr. 13390, date 17.12.2021, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.

NDRYSHIMI I MARRËVESHJES PËR BUJQËSINË
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË NORVEGJISË

Republika e Shqipërisë (në vijim e referuar si "Shqipëria") dhe Mbretëria e Norvegjisë (në vijim e referuar si "Norvegjia"),

duke pasur parasysh Marrëveshjen për Bujqësinë, të lidhur nga Shqipëria dhe Norvegjia në datën 17 dhjetor 2009, dhe e ndryshuar nga protokolli më 18 shtator 2015 (në vijim e referuar si "Marrëveshja");

duke vërejtur se Marrëveshja u lidh në vijim të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Shqipërisë dhe shteteve të EFTA-s, të nënshkruar më 17 dhjetor 2009, dhe në veçanti sipas paragrafit 2, të nenit 6, të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë;

duke vërejtur se Konventa Rajonale për Rregullat Preferenciale pan-euro-mesdhetare të Origjinës (në vijim e referuar si "Konventa") parashikon të zëvendësojë rregullat e origjinës aktualisht në fuqi ndërmjet Palëve Kontraktuese të sistemit pan-euro-mesdhetar;

duke vërejtur se Konventa hyri në fuqi për Shqipërinë në datën 1 maj 2012 dhe për Norvegjinë në datën 1 janar 2012;

duke synuar harmonizimin e rregullave të origjinës për Marrëveshjen me ato të Konventës,

bien dakord për ndryshimet e mëposhtme të marrëveshjes:

1. Teksti i nenit 3, të Marrëveshjes për Bujqësinë, zëvendësohet me tekstin në shtojcën e këtij vendimi.

2. Ky ndryshim do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, mbasi Palët kanë shkëmbyer instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit ose miratimit.

Bërë në Gjenevë, në datën 8 korrik të vitit 2021, në dy origjinale në gjuhën angleze.

Për Republikën e Shqipërisë	**Për Mbretërinë e Norvegjisë**

Neni 3

Rregullat e origjinës dhe bashkëpunimi administrativ

1. Të drejtat dhe detyrimet e Palëve, në lidhje me rregullat e origjinës dhe bashkëpunimin administrativ, rregullohen nga protokolli B i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë.

2. Çdo referencë ndaj "Shteteve të EFTA-s" në protokollin B konsiderohet se i referohet Norvegjisë.